



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 6 Korrik 2021

Nr: 98

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 57, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 05.07.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Relator
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijan RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Z. Andi Derhemi;

OBJEKT: Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 57, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 05.07.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124/1, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Z. Andi Derhemi, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 57 regj., datë 05.07.2021.

Në mbledhjen e datës 06.07.2021, ora 11:00, pas relativitetit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 57 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 17, pika 3, shkronjat “a” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 57, datë 06.07.2021, të paraqitur nga z. Andi Derhemi.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 7 Korrik 2021, në orën 9:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

